



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:229036
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876102

C.nr.823/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.A nga fshati R... Komuna e Mitrovicës dhe R.SH nga P..., kundër të paditurës DPH'....” me pronari F. dhe A.A.1 nga M... me çështjen juridiko – kontestimore: pasurim pa baze, vlera e kontestit 100.000 euro, me datë 28.06.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

- I.** **NDËRPRITET** procedura gjyqësore në këtë çështje juridike A.A dhe R.SH, kundër të paditurës DPH'....” pasi i autorizuari i paditësit e ka revokuar autorizimin dhe paditësi jam me adresë jashtë vendi dhe nuk ka caktuar përfaqësues tjetër.
- II.** Procedura do të vazhdoi, pas pushimit të shkaqeve për të cilat është ndërprerë, e në çdo moment, me propozimin e palëve ndërgjyqëse

A r s y e t i m

Paditësit A.A dhe R.SH nëpërmes përfaqësuesit të tyre, me datë 16.10.2018, kanë ushtruar në këtë gjykatë padi me bazë juridike pasurim pa baze, kundër të paditurit DPH “....” .

Me parashtresën e datës 03.04.2024 përfaqësuesi i paditësve autorizuar av Gazmen Ismajli ka njoftuar gjykatën se e tërheq autorizimin për përfaqësim ne ketë çështjen kontestimore dhe lidhur me ketë i ka njoftuar paditësit se te njëjtit tani e tutje do te përfaqësohen vet ose nga ndonjë avokat tjetër.

Meqenëse qe te dy paditësit jetojnë jashtë Kosovës atëherë i ka propozuar gjykatës që të mos merret asnjë veprim procedural derisa të njëjtit të vijnë gjatë verës në Kosovë.

Gjykata, duke marre parasysh rrethanat e lartë cekura, ku i autorizuari i paditësit e ka denoncuar autorizimin, e duke pasur parasysh faktin se me paditësin gjykata nuk ka mundur te komunikoj për shkak se te njëjtit jetojnë jashtë Kosove, me qellim te mos pësimi te pasojave procedurale

për paditësin, nën këto rrethana gjen tëyeshme duke u bazuar në nenin 277 dhe 278 të LPK-së që procedura të ndërpritet deri në paraqitjen e paditësit për vazhdimin e procedurës.

Meqenëse gjykata nuk mund të veprim sipas padis se paditëses, e duke u mbështetur në kuptim të dispozitave të nenit 277 dhe 278 par 1, pika b) e lidhur me nenin 387 par 1, pika e) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.823/2018 date 28.06.2024

Gjyqtari;
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.